

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Biljana Rexhiq, kryetare e kolegjit, Ferit Osmani dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Shaban Prekalla, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.M., nga Prishtina, për shkak të veprave penale Vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320 par.1 të KPRK-ës, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit H.M.- av.L.T. të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.966/2016, datë 09.02.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur 06.12.2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit, H.M.- av.L.T., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.966/2016, datë 09.02.2018, **vërtetohet**

### A r s y e t i m i

Gjykata Themelore Prishtinë me aktgjykimin P.nr.966/2016, datë 09.02.2018, të akuzuarin H.M., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320 par.1 të KPRK-ës, e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me kusht me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajsh, dhe dënim me gjobë në shumë prej 200.00 €(dy mijë euro), të cilat dënime nuk do të ekzekutohen në afat prej 1 viti, në qoftë se i akuzuari nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Është obliguar i akuzuari që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sa bëhen sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Pala e dëmtuar përfaqësuesi i KEDS në Prishtinë për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil. Udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt civil

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit H.M.- av.L.T., për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që gjykata e Apelit ta anuloj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën ta kthehej në rigjykim.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.1164/2018, datë 13.11.2018, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit H.M. av.L.T., ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar.**

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, por se nga përmbajtja e ankesës del se aktgjykimin e ankimon edhe për shkak të bazës ligjore shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike edhe pse në propozimin në ankesë thekson se aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ankimon vetëm sa i përket pjesës kur palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzon në kontest të rregullt juridiko civil , ndërsa për pjesën sa i përket pikës I dhe II të dispozitivit të aktgjykimi nuk e ankimon. Në ankesë dhe atë nga përmbajtja e ankesës thekson se i mbrojturi im nuk ka pasur në seancë mbrojtës dhe se nuk ka qenë i pajisur me shkresat e lëndës dhe se para paraqitjes së kësaj ankese i njëjti te unë ka ardhur vetëm me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe se sipas mbrojtësit për një kohë të shkurtër klienti i tij nuk ka mundur që të shpenzoj aq energji elektrike dhe si provë për këtë ja bashkangjet deklaratën e punëtorit të servisit.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate pretendimet e lartcekura të mbrojtësit të akuzuarit sa i përket kësaj baze ligjore janë të pa bazuara, ngase siq shihet nga shkresat e lëndës dhe atë nga procesverbali i seancës fillestare i datës 09.02.2018, të akuzuarit i është dorëzuar kopja e aktakuzës dhe e njëjta është lexuar nga ana e prokurorit e të cilën i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar dhe se është udhëzuar konform dispozitës së nenit 325 par.1 të KPPK-ës për deklarimin rreth fajësisë dhe pas marrjes së mendimit të prokurorit i akuzuari pasi që paraprakisht ka deklaruar që dëshiron që të mbrohet vetë e ka pranuar fajësinë dhe se gjykata me një aktvendim të posaçëm pasi që janë plotësuar kushtet ligjore konform dispozitës së nenin 248 e ka aprovuar pranimin e fajësisë së të akuzuarit dhe më pas të akuzuarit i ka shqiptuar dënim komulativ me gjobë dhe kushte si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Po ashtu kjo gjykatë duke u përkujdesur sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar sa i përket shkeljeve tjera esenciale edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Mbrojtësi i të akuzuarit e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për shkak të vendimit mbi dënimin- vendimin mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt juridiko civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike duke theksuar se udhëzimi i palës së dëmtuar në kontest të rregullt juridiko civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, duke

theksuar se është e pamundur që për një periudhë të shkurtër kohore të krijohen shpenzime aq të lartë pasi që as para kontrollës e as pas kontrollës nga njëhesori është hjekur një pjesë e plastikës- trak dhe se kaq shpenzime në shumë prej 3.401.49 është e pamundur që të shkaktohen për periudhë të shkurtër kohore dhe atë vetëm ditën e kontrollit nga ana e ekipes së KEDS-it.

Pretendimet e lartëcekura të mbrojtësit të të akuzuarit në këtë drejtim janë të pa bazuara, ngase i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor pasi që nga ana e prokurorit është lexuar aktakuza të njëjtën ka deklaruar se e ka kuptuar dhe po ashtu i njëjti pas udhëzimit nga ana e gjykatës për mundësin e deklarimit rreth fajësisë i njëjti e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorisë e në të cilën aktakuzë në mënyrë të saktë është theksua vlera e dëmit të shkaktuar palës së dëmtuar në shumë prej 3.401.49 €, dhe se me të drejtë gjykata e shkallës së parë palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

Nga të cekurat më lartë konform të dispozitave të nenit 401 të KPPK-s u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.1160/18, datë 06.12.2018

Zyrtari ligjor  
Shaban Prekalla

Kryetare e kolegjit  
Biljana Rexhiq

Anëtarët e kolegjit:  
Ferit Osmani  
Biljana Rexhiq